



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
Keshilli I Basenit Ujembledhes Mat

V E N D I M

Nr.4 Date 18.02.2008

Per Miratim te Kerkeses per Leje Koncesionare Perdorimi Uji Per Energji Elektrike ne lumin Mat, Perroi Zalli Dishit-Klos dhe Zalli Likones-Stavec, Subjektit : “Debojtron DOOEL shpk” me perfaqesues z.Georgi Georgieski.

Ne mbeshtetje te nenit 8 te ligjit nr.8093 dt. 21.03.1996 “Per Rezervat Ujore” , Keshilli i Basenit Ujembledhes Mat, VKM Nr.27 date 19.01.2007, si dhe udhizimit te perbashket i Ministrise Ekonomise dhe Energjetikes dhe Ministrise Mjedisit Pyjeve dhe Ujrave:

V e n d o s i:

1-Miratimin ne parim te kerkeses se dates 25.10.2007 te zotit Georgi Georgieski, administrator i “Debojtron Dooel” per Leje Kocesionare Perdorim Rezerva Ujore per Energji Elektrike lumi Mat, Perroi Zalli Dishit-Klos dhe Zalli Likones-Stavec, sipas studimit te paraqitur nga subjekti “Debojtron DOOEL shpk” i cili ka paraqitur kerkesen, me keto te dhena:

-Subjektit juridik/fizik “Debojtron DOOEL shpk” Burrel, lumi Mat, perroj Zalli Dishit-Klos:

- Prurja mesatare vjetore Perroit $Q=9\text{m}^3/\text{sek}$,
- Energjia e planifikuar vjetore $38.203.000\text{kwh}$,
- Prurja e planifikuar per vaditje $qv = \text{---} \text{m}^3/\text{sek}$
- Kuota e vepres se marrjes $A= 370\text{m}$,
- Disniveli min= 94m


-Subjektit juridik/fizik “Debojtron DOOEL shpk” Burrel, lumi Mat, perroj Zalli Likones, Stavec:

- Prurja mesatare vjetore Perroit $Q= \text{---} \text{m}^3/\text{sek}$,
- Energjia e planifikuar vjetore $\text{---} \text{kwh}$,
- Prurja e planifikuar per vaditje $qv = \text{---} \text{m}^3/\text{sek}$
- Kuota e vepres se marrjes $A= 350\text{m}$,
- Disniveli min= 84m

2-Mbas perfundimit te objektit, subjekti “Debojtron DOOEL shpk” shpk duhet te kete lidhur marrveshjen e perdorimit te ujit me K.B.Mat sipas percaktimeve qe parashikohen ne ligj. Nuk lejohet ndryshimi i regjimit te vaditjes apo i furnizimit me uje te popullates nga perdorimi i ujit per energji elektrike.

3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.U.B. MAT
Pashk NDOCI



KRYETARI I K.B.U. MAT
Ntazi REÇI

